



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna Rahovec / Opština Orahovac / Municipality of Rahovec



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenja za Opštu Upravu



-III- Nr. i prot. 1527 Më 30.04.2024
Br. prot. Dt.

Mbështetur në Ligjin Vetëqeverisje lokale Nr.03/L-040, neni 14, pika 14.2, Ligjin për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, nenit 14 të Rregullores (QRK) nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, Statutit të komunës së Rahovecit, i datës 29.3.2017, vendimit të Kuvendit Komunal të Rahovecit, 01 Nr.198, të datës 29.2.2024, Komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, i caktuar me vendimin e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, nr.01/199, të datës 29.2.2024, shpall këtë:

NJOFTIM PUBLIK PËR SHPREHJE TË INTERESIT

PËR DHËNIEN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË SHFRYTËZIM AFATGJATË

1. Njoftimi publik për dhënie e pronës së paluajtshme përmes shprehjes së interesit, përmban si në vijim:

1.1. Prona e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim afatgjatë është në zonën kadastrale Rahovec, në vendin e quajtur *Ravne Shume*, me kulturë kullosë e klasës 5, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë P-71510057-02302-1, në sipërfaqe të përgjithshme prej 162513m² (njëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e pesëqind e trembëdhjetë metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komunës së Rahovecit.

1.2. Prona e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim afatgjatë është në zonën kadastrale Rahovec, në vendin e quajtur *Grot*, me kulturë kullosë e klasës 7, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë P-71510057-02299-0, në sipërfaqe të përgjithshme prej 6806m² (gjashtë mijë e tetëqind e gjashtë metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komunës së Rahovecit.

2. Çmimi:

- Çmimi fillestar për dhënie në shfrytëzim afatgjatë përmes shprehjes së interesit të pronës së paluajtshme të komunës, do të jetë 0,1.5 € (një pikë zero pesë cent për metër katror) për m².

Afati i dhënies në shfrytëzim

Afati i dhënies në shfrytëzim, të pronës së paluajtshme të Komunës, të cëkur në pikën 1.1, do të jetë afatgjatë prej 25 (njëzet e pesë) vitesh.

b. Veprimtaria që ushtrohet sipas destinimit të pronës:

Prona komunale për dhënie në shfrytëzim përmes shprehjes së interesit, sipas pikës 1.1 të kësaj thirrjeje, do të jepet në shfrytëzim për vendosjen e paneleve solare, përmes shprehjes së interesit.

c. Kohëzgjatja e shpalljes së thirrjes publike dhe data e fundit e dorëzimit të ofertave:

Kohëzgjatja e shpalljes së thirrjes publike për dhënie e pronës në shfrytëzim afatgjatë është pesëmbëdhjetë (15) ditë nga koha e publikimit në faqen ueb të Komunës, në vendet publike, elektronike dhe të shkuara. Ofertat dorëzohen të mbyllura nëpërmjet zyrës së prokurimit në Rahovec, nga data 1.5.2024, deri më datë 15.5.2024, nga ora 09:00, deri në orën 15:00.

Vendi, koha ku do të mbahet hapja e ofertave:

Në sallën e Kuvendit Komunal, më datë 17.5.2024 në fillim në orën 13:30, do të bëhet hapja e ofertave të mbyllura dhe të njëjtat do të bëhen publike gjatë hapjes, duke siguruar qasje të drejtpërdrejtë për pjesëmarrësit në ankand publik.

d. Kushtet apo kufizimet mbi dhënie e të drejtave për shfrytëzim:

Prona nuk mund të përdoret për qëllime të tjera përpos siç është përcaktuar në thirrjen publike dhe e njëjta nuk mund të bartet në personin e tretë.

II. Të drejtat dhe përgjegjësitë e pjesëmarrësve në ankand publik:

- a. Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë personat fizikë dhe juridikë;
- b. **Personat fizikë**, krahas aplikacionit në kuvertë, duhet të ofrojnë edhe kopjen e letërnjoftimit dhe dëshminë mbi pagesën e tatimit në pronë me afat;
- c. **Personat juridikë**, krahas aplikacionit në kuvertë, duhet ta bashkëngjisin edhe:
 - a. Certifikatën e regjistrimit të biznesit me informata (NUI);

- b. Vërtetimin e taksës komunale në afarizëm;
- d. Vërtetimin nga Administrata Tatimore, e cila ka afatshmëri;
- e. Letërnjoftimin kopje;
- f. Referencat në fushën e paneleve solare (joobligative);

III. Kriteret për aplikim:

4. Oferta ekonomikisht më e favorshme

- 4.1. Çmimi më i lartë i qirasë mujore.....40 pikë
- 4.2. Aktiviteti - paneli solar30 pikë
- 4.3. Referencat (joobligative)10 pikë
- 4.5. Projekti investiv për 25 vjet..... 20 pikë

Pjesëmarrësve, në konkurrim iu garantohet e drejta që të:

Informohen lidhur me procedurat e thirrjes publike;

Shohin pronën që do të jepet në shfrytëzim;

Kanë qasje në dokumentacionet e pronës;

Tërhiqen nga ofertimi jo më vonë se tre (3) ditë para hapjes së ofertave.

Fituesi duhet të nënshkruajë regjistrin e procedurës së thirrjes publike. Nëse informatat e dhëna nga ofertuesi dëshmohen si të pasakta, komisioni ka të drejtën që të refuzojë dhënien e pronës në shfrytëzim.

IV. Raporti i vlerësimit të ofertave dhe procedura e nënshkrimit të kontratës:

- a. Komisioni vlerësues brenda tri (3) ditë pune nga përfundimi i vlerësimit të ofertave në ankand publik, harton raportin përfundimtar për përmbylljen e ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës.

b. Raporti përfundimtar i komisionit vlerësues të ofertave të ankandit publik përmban:

Një kopje të shpalljes së thirrjes publike;

Procesverbalin e raportit të vlerësimit;

Rekomandimin e komisionit për zgjedhjen e fituesit;

Një kopje të protokolluar të ofertës së përzgjedhur.

Ankesat e parashtruara nga pjesëmarrësit në thirrjen publike

- V. Pas miratimit të ofertës së përzgjedhur nga komisioni vlerësues, njoftimi i dërgohet fituesit dhe i njëjti publikohet në tabelën e shpalljeve dhe në faqen ueb të Komunës. Ofertuesi me çmimin më të lartë të ofruar, do të shpallet fitues gjatë procesit të hapjes së ofertave.
- VI. **Pala e pakënaqur me vlerësimin e komisionit, ka të drejtë të parashtojë ankesë në komisionin për vlerësimin e ankesave në afat prej shtatë (7) ditësh.**
- VII. Nëse Komisioni i ankesave konstaton se ka shkelje gjatë procesit të vlerësimit, ka të drejtë të kërkojë rishqyrtimin e procesit, por nëse komisioni i ankesave vlerëson se nuk ka bazë, atëherë ankesën e refuzon si të pabazuar.
- VIII. Kontrata për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, nënshkruhet nga Kryetari i Komunës dhe fituesi i zgjedhur, brenda 15 ditësh pune nga data e miratimit të ofertës nga ana e komisionit vlerësues.

Vërejtje: Tërheqja e aplikacioneve për konkurrim bëhet në formë fizike në Zyrën e Prokurimit në Rahovec.

Rahovec, 30.4.2024